

Raporti mbi procesin KOMRA: tetor – dhjetor 2014.

Të deleguarit për KOMRA¹ e përfunduan mandatin e tyre më 28.10.2014. Gjatë një viti, me punën e tyre të përbashkët dhe konsultime me presidentë e anëtarë të Presidencës së BeH të cilët i deleguan, ata kanë bërë **Ndryshime të Statutit të KOMRA-së** të cilat, sipas mendimit të tyre, paraqesin mundësi ligjore dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-së.

Kuvendi VII i Koalicionit për KOMRA

Në përputhje me rregullat e Koalicionit për KOMRA, Kuvendi i Koalicionit mori vendim për dhënien e mbështetjes për Ndryshimet e Statutit të KOMRA-së që e miratoi më 26.3.2011.

Në këtë drejtim, më 14 nëntor 2014 në Beograd (Serbi) Koalicioni e mbajti Kuvendin, të shtatin me radhë, me pjesëmarrje të 104 delegatëve që përfaqësonin 1950 anëtarë/e. Delegatët, me një votë kundër dhe dy abstenime, mbështetën **Ndryshimet e Statutit të KOMRA-së**, që i bënë të deleguarit e presidentit të Malit të Zi, Serbisë, Kroacisë dhe Kosovës, anëtarët bosnjakë dhe kroatë të Presidencës së BeH², dhe lidhur me detyrën për t'i shqyrtuar mundësitë ligjore dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-së në çdo shtet individualisht.

Në një diskutim të gjerë, delegatët vlerësuan se me Ndryshimet „është ruajtur thelbi i Propozim-Statutit, se heqja e kompetencave represive largon dyshimet se KOMRA i merr përsipër kompetencat e organeve gjyqësore, dhe se procedura e kandidimit dhe zgjedhjes së bordeve selektuese dhe anëtarëve të Komisionit është thjeshtësuar në masë të konsiderueshme”. Në emër të Koalicionit për KOMRA, delegatët i përshëndetën fuqishëm ndryshimet në financimin e Komisionit, me të cilat parashihet që KOMRA të financohet me donacione vendore dhe ndërkombëtare, pastaj me mjete të organizatave ndërkombëtare, dhe jo nga kontributet shtetërore, siç propozonte Koalicioni.

Delegatët në veçanti e përshëndetën qëndrimin e të deleguarve që në mesin e qëllimeve të Komisionit të jetë edhe „përmirësimi i programeve arsimore në përputhje me faktet që i vërteton Komisioni.”

Me rastin e mbështetjes së Ndryshimeve të Statutit, duke iu drejtuar publikut³, Koalicioni theksoi se në mes të të deleguarve dhe presidentëve/anëtarëve të Presidencës u arrit pajtimi i plotë rreth asaj që Komisioni duhet të vërtetojë fakte rreth krimeve të luftës si dhe rreth shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut, të kryera në periudhën nga 1 janari i vitit 1991 deri në dhjetor të vitit 2001. Koalicioni vuri në pah se, sa i përket detyrës së KOMRA-së që të „hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat përfundimisht i kontribuuan shpërthimit të luftërave, si dhe kryerjes së krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të të drejtave të njeriut”, u shprehën dy mendime: „është thelbësore që KOMRA t'i hulumtojë shkaqet e luftës” dhe „hulumtimi i shkaqeve të luftës është i

¹ Prof. dr Zlata Đurđević, e deleguara e presidentit të Kroacisë; prof. dr Sonja Tomović Šundić, e deleguara e presidentit të Malit të Zi; këshilltari ligjor Selim Selimi, i deleguari i presidentes së Kosovës; zëvendëskryetari i komunës së Sarajevës Aljoša Čampara, i deleguari i anëtarësisë së Presidencës së BeH; zyrtar për lidhje me Tribunalin e Hagës, Goran Mihaljević, i deleguari i anëtarësisë së Presidencës së BeH dhe gjykatësi Siniša Vazić, i deleguari i presidentit të Serbisë.

² Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, e informoi Koalicionin për KOMRA se do ta mbështesë vendimin për themelimin e KOMRA-së, nëse do të ketë konsensus ndërmjet presidentëve/Presidencës së BeH.

³ Koalicioni për KOMRA mbështet Ndryshimet e Statutit të KOMRA-së, komunikatë për shtyp, 17.11.2014.

mundshëm pas vërtetimit të fakteve rreth krimeve të luftës”, të cilat janë në përputhje të plotë me propozimet e Koalicionit për KOMRA.

Letër presidentëve/anëtarëve të Presidencës së BeH

Më 10 dhjetor 2012 Koalicioni për KOMRA i drejtoi një letër presidentëve/anëtarëve të Presidencës së BeH, duke i rikujtuar se Kuvendi i mbështeti Ndryshimet e Statutit të KOMRA-së, me çka janë krijuar kushtet për hapin e ri drejt themelimit të Komisionit Regjional për vërtetimin e fakteve rreth krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut gjatë luftërave në territorin e ish Jugosllavisë. Në letrën e përmendur, Koalicioni theksoi se pret që presidentët/anëtarët e Presidencës së BeH të merren vesh rreth formës së informimit të publikut dhe parlamenteve në lidhje me atë se kanë vendosur që bashkërisht ta mbështesin themelimin e Komisionit. Letra i ftoi presidentët/anëtarët e Presidencës së BeH t'i kushtojnë vëmendje propozimit të presidentit të Kroacisë që të gjithë, në një afat të dakorduar, t'i drejtojnë letër publikut dhe parlamenteve lidhur me mbështetjen e përbashkët për themelimin e KOMRA-së.

Me rastin e njëjtë, Koalicioni i informoi presidentët/anëtarët e Presidencës së BeH se ai ka përparuar dukshëm në dokumentimin e humbjeve njerëzore, llogorëve dhe objekteve tjera të burgosjes në luftërat e viteve të nëntëdhjeta.

Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) nga Serbia dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) në Ditën e të Drejtave të Njeriut në uebfaqen e Librit të Kujtimit të Kosovës vendosën Regjistrin e të vrarëve dhe të të zhdukurve në lidhje me luftën në Kosovë, në periudhën nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000. Regjistri përmban 13.517 viktima të luftës, vdekjen apo zhdukjen e të cilëve lidhur me luftën e konfirmojnë 27.511 dokumente.

Qendra për Ballafaqim me të Kaluarën – Documenta nga Kroacia dhe FDH-ja ka tri vite që zbatojnë një hulumtim empirik mbi viktimat që humbën jetët apo u zhdukën në luftë në Kroaci, duke marrë deklaratat nga dëshmitarët dhe anëtarët e familjeve.

Shoqata për Drejtësi Tranzicionale, Përgjegjësi dhe Kujtesë në BeH (TPOS) dhe Qendra për Demokraci dhe Drejtësi Tranzicionale (CDTP) në fund të vitit 2013 e filluan projektin „Hartëzimi i llogoreve dhe objekteve tjera të burgosjes në BeH”, që në mënyrë të drejtpërdrejtë i kontribuon përmbushjes së mandatit të KOMRA-së në pjesën që ka të bëjë me regjistrimin individual të viktimave civile dhe ushtarake si dhe të objekteve të burgosjes.

„Mosveprimi” momental

Duke marrë parasysh se në BeH u zgjodh Presidenca e re⁴ pasi që të deleguarit, në konsultime me presidentët/anëtarët e Presidencës së BeH, i bënë dhe i miratuan Ndryshimet e Statutit të KOMRA-së, para Komisionit vihet obligimi që t'i konsultojë anëtarët e ri të Presidencës: anëtarin kroat, Dragan Čović-in, si dhe anëtarin serb, Mladen Ivanić-in.⁵ Arsyeja tjetër, e cila ndikon në „mosveprimin” momental të procesit KOMRA janë zgjedhjet presidenciale në Kroaci⁶, të cilat mbahen më 11 janar të vitit 2015.

Nëse në vitin 2015 do të ketë mbështetje sikur që kishte në vitin 2014, ka mundësi serioze që shtetet postjugosllave, për herë të parë në histori të shoqërive pas konfliktit, në mënyrë të

⁴ Presidenca e BeH u konstituua më 17.11.2014.

⁵ Anëtari serb në përbërjen e kaluar të Presidencës, Nebojša Radmanović, nuk mori pjesë në procesin KOMRA.

⁶ Rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale mbahet më 11.1.2015.

pavarur, pa kushtëzime e presione të bashkësisë ndërkombëtare, të fillojnë me ndërtimin e mekanizmit regional për ballafaqim me të kaluarën i cili ka potencial t'i heqë mangësitë e drejtësisë penale dhe bllokadën politike të zbulimit të varrezave të mbetura masive, t'i vërtetojë faktet për të gjitha krimet e luftës, të sigurojë respektim të përvojave personale dhe të dinjitetit të tjerëve.

Forumi X për drejtësinë tranzicionale në vendet postjugosllave

„Ekziston një njësi matëse, e kjo është mitingu i radikalëve sot, këtu në Beograd. Unë ju pyes tani – kush janë fitimtarët? Vetëm merreni me mend situatën para dhjetë vitesh, a do të ishte e mundur që ne këtu, në këtë sallë, të bisedojmë e ata në shesh? Ky do të ishte disproporcion i panatyrshëm i fuqisë, dhunës, forcës kundrejt grupit të njerëzve i cili beson në vlerat themelore njerëzore. Sot ne këtu, pavarësisht asaj se disa vërtetë kanë humbur shumë, para së gjithash më të dashurit e tyre, jemi fitimtarë në sistemin e vlerave në raport me ata njerëz të cilët tani janë humbës atje në njëfarë sheshi.”⁷

Forumi X iu kushtua të arriturve në drejtësinë tranzicionale, promovimit të përdorimit të fakteve në veprat artistike dhe dëgjimit të zërit të viktimave. Forumi u mbajt më 15 dhe 16 nëntor 2014 në Beograd, në organizim të Koalicionit për KOMRA. Në punimet e Forumit morën pjesë 158 anëtarë të Koalicionit për KOMRA si dhe 150 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, artistë, shkrimtarë, hulumtues akademikë të drejtësisë tranzicionale, gazetarë si dhe individë tjerë të cilët në aspektin profesional apo të aktivizmit merren me drejtësinë tranzicionale në vendet postjugosllave. Dymbëdhjetë panelistë në Forum folën për të arriturat në fushën e drejtësisë tranzicionale nga këndvështrimi i shoqërisë civile dhe komunitetit akademik, për përdorimin e fakteve në veprat artistike folën gjashtëmbëdhjetë panelistë, ndërsa për përvojat personale gjatë luftës dhe kërkimit të mbetjeve mortore të më të afërmeve të tyre folën dymbëdhjetë viktima.

Forumin e hapi Nataša Kandić, koordinatore e projektit KOMRA dhe profesori Zdravko Grebo, avokues publik i Nismës për KOMRA. Ata paralajmëruan fazën e re të procesit KOMRA, në të cilën Koalicioni përcjell, ndihmon dhe i nxit institucionet shtetërore ta themelojnë KOMRA-në. Ata i ftuan anëtarët e Koalicionit të përgatiten për aktivitete të reja dhe tërhoqën vërejtjen lidhur me atë se në Ballkan ndryshimet ndodhin nga çasti në çast.

Profesor Grebo vlerësoi: „Në nivel të shoqërisë civile dhe të sektorit joqeveritar, ne e kemi kryer misionin tonë. Natyrisht se unë flas në emrin tim dhe nuk do t'i lejoj askujt që, pa kurrfarë rezerve, ta drejtojë atë ashtu siç i teket, por e kemi arritur momentumin kur presidentët e shteteve, përmes të deleguarve të tyre, duhet ta marrin çështjen në duart e tyre, sepse ajo detyrë e cila është para nesh, sado që do të dëshironim, ne nuk mund ta kryejmë.”

Paneli I: ~Të arriturat dhe prioritetet në drejtësinë penale – vlerësimi nga këndi i shoqërisë civile

⁷ Branislav Radulović, jurist nga Mali i Zi, anëtar i Koalicionit për KOMRA.

Drejtësia penale për krimet e kryera gjatë luftërave të viteve të nëntëdhjeta në hapësirën e RSFJ-së së dikurshme deri më sot nuk i është afruar realizimit të qëllimeve të saj. Në të gjitha shtetet e atij regjioni ende mbizotëron disproporcioni ndërmjet krimeve të kryera dhe atyre të procesuara, ndërsa përpara gjykatave vendore nuk ka proces i cili ndërshtërisht dhe objektivisht e qartëson rolin e shtetit në organizimin dhe kryerjen e krimeve dhe i cili i procedon urdhërdhënësit nga maja e pushtetit. Është posaqërisht brengosëse që në të gjitha ato vende ende vërehet qartë ndikimi i fuqishëm në sistemin e drejtësisë. Ai ndikim manifestohet në mënyra të ndryshme, por më së shumti vërehet përmes pengimit të gjykimeve për krime lufte. Përfundimi i panelistëve dhe i pjesëmarrësve në debat ishte se është e dukshme që numri i proceseve gjyqësore nga viti në vit po zvogëlohet.

Tea Gorjanc Prelević nga organizata „Aksioni për të drejtat e njeriut” ka vlerësuar se, përkundër rekomandimit të Komisionit European se duhet ndërprerë praktikën e mosndëshkimit për krime të luftës, autoritetet në Mal të Zi tregojnë se procedimi i krimeve të luftës është një proces praktikisht i përfunduar. „Mungesa e dukshme e vullnetit, në të gjitha nivelet, që të dënohen krimet e luftës në Mal të Zi është pasojë logjike e faktit se kryeministri i Malit të Zi është personi i njëjtë i cili ka qenë në atë pozitë në kohën kur ndodhnin ato krime. Për sistemin e drejtësisë i cili aspiron drejt Europës ky fakt duhej të kishte qenë shtysë për të dëshmuar gatishmërinë për shqyrtimin dhe ballafaqimin me krimet nga e kaluara. Dhe megjithëse është e qartë që Mali i Zi nuk ka një sistem të tillë të drejtësisë, tani të paktën u bë e qartë se Bashkimi European instiston për një sistem të tillë për ta pranuar Malin e Zi,⁸ prandaj kjo mbetet shpresë për përmirësim”, tha Gorjana Prelević.

Paralele të ngjashme në raport me autoritetet karshi procedimit të krimeve të luftës në Kroaci tërhoqi edhe **Vesna Teršelić**, drejtuese e organizatës joqeveritare Documenta. „Në Kroaci”, theksoi ajo, „Prokuroria e shtetit i është besuar atyre të cilët gjatë të nëntëdhjetave kanë marrë pjesë në mbulimin e krimeve.” Për disa profesionistë ishte e arsyeshme të pritej që në rrethanat e reja politike ata do ta shfrytëzonin rastin për një punë më cilësore, por me këtë domosdoshmërisht i është besuar vazhdimi i procedimeve të ndërprera njerëzve të njëjtë të cilët për shkak të oportunitizmit politik me vetëdije të plotë i kanë ’harruar’ ato raste, në mënyrë që të mos e rrezikonin pozitën e tyre apo ngritjen në detyrë në polici dhe prokurori të shtetit”, tha Teršelić.

Edhe në Serbi, drejtësia penale pati rezultate modeste „duke i matur në bazë të shkallës dhe karakterit të krimeve të kryera në luftërat e zhvilluara në territorin e ish Jugosllavisë, përkundër kornizës solide ligjore e institucionale”, vlerësoi **Sandra Orlović**. Pasojat më të rënda nga veprimi i papërgjeshëm i institucioneve i bartin viktimat, e pastaj edhe dëshmitarët, në kuadër të mbrojtjes dhe mbështetjes në proceset për krime të luftës. „Njëri prej shkaqeve për të arriturat modeste në fushën e procedimit të përgjegjësve për krime të luftës është edhe fakti se Serbia, në dallim nga BeH dhe Kroacia, nuk ka Strategji për procedimin e krimeve të luftës. Në këtë aspekt, miratimi (dhe zbatimi) i strategjisë, përmes së cilës institucionet relevante do të merrnin përsipër

⁸ „Nuk ka pasur përpjekje serioze që të luftohet mosndëshkimi për krime lufte. (...) Mali i Zi duhet t'i përshpejtojë përpjekjet për ta luftuar mosndëshkimin dhe me efikasitet t'i hetojë, procedojë, gjykojë dhe dënojë krimet e luftës në përputhje me standardet ndërkombëtare. “ Raporti i Progresit i Komisionit European për Malin e Zi i vitit 2014, citat i Tee Gorjanc Prelević-it.

më shumë përgjegjësi dhe detyra konkrete për t'i çuar tutje procedimet për krime të luftës në periudhën e ardhshme, paraqet një domosdoshmëri”, vlerësoi Orlović.

Sa i përket rajonit, në Bosnje e Hercegovinë po zhvillohet numri më i madh i gjykimeve për krime të luftës. Një aparat aq i madh in sistemit të drejtësisë do të duhej të ishte përgjigje e duhur në faktin se në BeH u krye numri më i madh i krimeve dhe se atje ka më së shumti viktimat. **Dženana Karup Druško** nga Shoqata për Drejtësi Tranzicionale, Përgjegjësi dhe Kujtesë në BeH (TPOS) ka tërhequr vërejtjen lidhur me moszbatimin e Strategjisë shtetërore për punë rreth lëndëve të krimeve të luftës, të miratuar në vitin 2008, përmes së cilës ishte e paraparë që rastet komplekse të kryheshin deri në vitin 2015, ndërsa rastet tjera deri në vitin 2023. „Tani është plotësisht e sigurtë se këto afate nuk do të përmbushen”, konkludoi ajo.

Edhe në BeH – e cila mban mbi supë barrën më të madhe të trashëgimisë së luftës – sistemi i drejtësisë ballafaqohet me pengesa politike, përkundër faktit se ky shtet ende është me status të protektoratit ndërkombëtar. Një përfundim të tillë nxori edhe Komisioni European në Raportin e Progresit të BeH për vitin 2014. Kjo është posaçërisht e dukshme kur bëhet fjalë për marrëveshje me vendet tjera të rajonit të cilat, ndër të tjera, duhet të mundësojnë ekstradimin e shtetasve të dyshuar (apo të dënuar) për krime lufte. Edhe këtë fakt e rikujtoi Dženana Karup Druško. „Nuk është numër i vogël rastesh që personat kundër të cilëve zhvillohet ndjekja penale në BeH, duke përfshirë edhe ata të cilët u dënuan përfundimisht, gjejnë strehë në Serbi, Mal të Zi e Kroaci, duke e shfrytëzuar shtetësinë e dyfishtë. Me këtë nuk respektohen marrëveshjet e nënshkruara të BeH me Serbinë, Kroacinë dhe Malin e Zi për zbatimin e sanksioneve penale (shembull: rastet e verdikteve të plotfuqishme kundër Momira Savić-it, Boško Lukić-it, Velibor Bogdanović-it, Mirko Todorović-it). Çështjet e pazgjidhura ndërshtetërore në fushën e ndjekjes së kriminelëve në masë të madhe janë zgjidhur me nënshkrimin e protokollit dhe të marrëveshjes, por ato nuk i kanë zgjidhur edhe problemet”, thekson Dženana Karup Druško.

Ndryshe nga BeH, Kosova ka kapacitete shumë të kufizuara vendore për procedimin e krimeve të luftës. Ka disa vite që zhvillohet procesi në kuadër të të cilit EULEX-i e zvogëlon misionin e tij dhe i bart kompetencat tek organet kosovare. „Shtrohet pyetja, si do t'ia dalin institucionet kosovare me përgjegjësitë më të mëdha karshi viktimave të luftës në përgjithësi, e sidomos karshi personave të zhdukur. Shikuar në përgjithësi, ende nuk ekziston mbështetje e mjaftueshme politike dhe mekanizma të duhur për grumbullimin e informatave relevante për kryerjen e hetimeve për krime lufte dhe për persona të zhdukur. Frikësimi i dëshmitarëve është ende një problem brengosës, megjithëse policia ka arritur një përparim të dukshëm me themelimin e Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve”, vlerësoi **Nora Ahmetaj** nga Qendra për Dokumentim, Hulumtim dhe Publikim (CDRP). Ajo i ftoi organizatat joqeveritare dhe Koalicionin për KOMRA ta inkurajojnë KE-në të ndërtojë strategjinë e drejtësisë tranzicionale në shoqëritë pas konfliktit e cila do ta zëvendësonte obligimin „për bashkëpunim me Gjykatën Ndërkombëtare për Krime në ish Jugosllavi (GJNKJ)”, që për vite me radhë interpretohet si instrument i drejtësisë tranzicionale.

Duke folur për të arriturat dhe prioritetin e Gjykatës së Hagës, **Mirko Klarin** theksoi se faktet e gjykatës janë gjëja më e vlefshme që do të mbetet si trashëgimi e kësaj gjykate ndërkombëtare: faktet se çka ka ndodhur, çka kanë përjetuar viktimat, si ka ndodhur. „Mbase nuk kemi vërtetuar gjithmonë saktë se kush ka faj – dhe kjo është një mangësi me peshë, por edhe pa këtë, faktet e vërtetuara janë tejet të rëndësishme për t'u ruajtur për të ardhmen dhe për t'iu prezantuar në

mënyrë të drejtë, si komuniteteve të viktimave ashtu edhe komuniteteve të cilave i përkasin kryesit, konkludoi Klarin.

Procesi REKOM: prof. Žarko Puhovski

„Ne vazhdimisht kemi përjetuar dështim pas dështimi, gjithmonë na kanë refuzuar, ne luteshim, ata na refuzonin, gjithmonë thonin 'pritni pak, do të shohim', por disi u jemi mërzhitur, disave prej tyre. E kjo nuk është gjendje e tanishme, ku duhet pasur parasysh se nuk kemi ardhur te pika që quhet „point of no return” (pikë e pakthimit). Kjo është pikë e pakthyeshmërisë. E gjithë kjo mund të ndryshojë. Dhe nuk kemi mundur të zgjedhim as me kë do të bisedojmë, por kemi biseduar me ata të cilët, nëse gjenin vullnet të mirë, mund të bënin diçka. Bëhej fjalë për atë se a mund t'i bindim që për ta është gjë e mirë ta bëjnë këtë. Por tani kemi ardhur deri aty që të kemi qëndrim të qartë të presidentit kroat, të cilin e ndajnë edhe dy presidentë e gjysmë të tjerë, të themi tani për tani, i cili thotë kështu: „Presidenti i shtetit, në marrëveshje me presidentët e shteteve postjugosllave, do t'i japë deklaratë parlamentit të vet se e mbështet procesin KOMRA dhe se për këtë arsye kërkon që parlamenti të ndërmarrë hapa të cilat janë të nevojshme që KOMRA të bëhet ajo që ishte qëllimi i saj parësor – ndërshtetërore, pra, Komision Regjional për vërtetimin e fakteve rreth krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në territorin e ish RSFJ-së.”

Pra, suksesi ynë i madh, nëse ndonjëherë do të vinte deri te ai, do të ishte shpalosja e akteve çnjerëzore përpara opinioneve publike të shteteve postjugosllave. Por ky do të ishte suksesi në aspektin në të cilin Zdravko Grebo foli në hyrje – të parandalohet ajo që tanimë është interpretim viktimologjik postjugosllav – kush ka më së shumti viktimë dhe pastaj kush e ka pozitën më të mirë strategjike për konfliktin e ardhshëm. Kjo do të duhej të parandalohej, nëse do të kemi sukses në diçka që jemi duke bërë tani – dhe prandaj ne megjithatë merremi më shumë me të ardhmen sesa me të kaluarën”.

Reparacionet për krime lufte në ish Jugosllavi

Igor Cvetkovski nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) vlerësoi se në vendet postjugosllave reparacionet dhe vërtetimi i së vërtetës si themele të konceptit të drejtësisë dhe praktikës tranzicionale, janë lënë pas dore dhe janë vendosur në planin e dytë. Moderator ishte Nenad Golčevski, Outreach program, GJNKJ.

Paneli II: Të arriturat dhe prioritetet e drejtësisë tranzicionale – vlerësimi nga këndvështrimi i komunitetit akademik

Profesoresha **Svetlana Slapšak** u përkushtua fuqishëm për problematizimin e etikës së zekthit⁹ në politikat dhe shoqëritë ballkanike bashkëkohore sepse „në narracione të cilat krijojnë identitete të reja nuk ka aspak vend për përgjegjësi, ndëshkim dhe pajtim: ajo fushë mund të gjejë vend në shoqëritë e reja vetëm në bashkëpunim të aktivizmit, akademisë dhe artit. Vetë sistemi shtetëror, me gjithë padrejtësitë e tij të cilat sot dëshmohen në një numër padurueshmërisht të madh, nuk bie ndesh me këto kërkesa”.

9 Njëra nga figurat e suksesshme të Platonit – metafora: në *Mbrojtjen e Sokratit* (30e-31c), Sokrati i paralajmëron athinasit se, nëse e mbysin, do ta humbin dhuntinë të cilën u ka dhënë zoti, ta kenë dikë i cili gjithmonë do t'ua tërheqë vërejtjen, t'i thumbojë, t'i shtyjë të mendojnë; ai e krahason demokracinë athinase me një kalë të madh e fisnik, por të ngadalshëm e të palëvizshëm të cilin vetëm thumbimi i zekthit mund ta vë në lëvizje.

Jelena Subotić, as. profesoreshë (Georgia State University), ndër të arritura konkrete në fushën e drejtësisë tranzicionale në regjionin e Ballkanit Perëndimor, veçoi krijimin e arkivës së dokumenteve dhe kultivimin e konceptit të „drejtësisë tranzicionale” në vetëdijen publike. Subotić këto të arritura i shpjegon: „Falë aktiviteteve të GJNKJ-së, në masë më të vogël, gjykatave vendore për krime lufte, sot kemi në dispozicion një sërë dokumentesh e të dhënash për shkelje të të drejtave të njeriut nga vitet e nëntëdhjeta dhe vlera e tyre është e jashtëzakonshme. Asgjë nga ai dokumentacion sot nuk do të ekzistonte pa gjykatat ndërkombëtare dhe pa përpjekje të aktivistëve për të drejtat të njeriut në kërkim të drejtësisë ndërkombëtare. Edhe pse në vendet e ish Jugosllavisë drejtësia tranzicionale mbase nuk është aq e popullarizuar, e as nuk është trajtuar me respekt të cilin e meriton (dhe për të cilin ka shumë nevojë), prapëseprapë duhet theksuar një fakt të rëndësishëm. Në fakt, sot të gjithë e dinë çka është „drejtësia tranzicionale”. Kjo nuk është gjë e vogël. Aktivistët në fushën e drejtësisë tranzicionale ia kanë dalur ta vendosin idenë e drejtësisë pas konfliktit apo ballafaqimit me të kaluarën në diskursion e gjithëmbarshtëm nacional. Ndoshta nuk do të na pëlqejë gjithçka që ai ka prodhuar, por dialogu megjithatë ekziston. Ky është një dallim shumë i madh në raport me gjendjen e drejtësisë tranzicionale para pesëmbëdhjetë ose, madje, dhjetë vitesh. Drejtësia tranzicionale sot është e pranishme, dhe kjo nuk do të ndryshojë.”

Jasna Dragović Soso, ligjëruese e lartë (Goldsmiths, University of London), vuri në pah se, të paktën në literaturën profesionale, komisionet për të vërtetën në thelb paraqesin institucione politike. E vërteta të cilën e bartin komisionet për të vërtetën, pashmangshëm e privilegjon një narrativë mbi të kaluarën me çka, në fakt, shtypet apo anashkalohet gjithçka tjetër. Në këtë mënyrë, vendimet rreth asaj se cila narrativë do të jetë e privilegjuar, si duhet të definohen viktimat dhe kryesit apo të vërtetohen shkaqet dhe përgjegjësitë për ngjarjet dhe krimet të cilat komisioni përpiket t'i përshkruajë – janë vendime të qenësishme politike dhe domethënia e tyre është tejet e madhe. Kur bëhet fjalë për praninë e kësaj natyre të qenësishme politike të komisioneve për të vërtetën, mendoj se është pikënisje e mirë pikërisht qasja të cilën e ka KOMRA, e cila fillimisht është e orientuar drejt vërtetimit të fakteve dhe viktimave individuale. Krijimi i arkivës së fakteve të vërtetuara e të pranuar zyrtarisht mbi shkeljet e të drejtave të njeriut në rajon, së bashku me narrativën e cila është e orientuar drejt viktimave, paraqet hapin e parë drejt një gjëje që unë e konsideroj si shumë të rëndësishme, e ajo është dialogu mbi të kaluarën”.

Eric Gordy, ligjërues (University College London), shpalosi mendimin, të cilin e nxori nga hulumtimi, se „thelbi për tejkalimin e konflikteve dhe zhvelimin e dialogut mbi të kaluarën lidhet me kujtesën e përbashkët dhe bazohet jo vetëm në faktet e vërtetuara por edhe në pranimin dhe konfirmimin e dyanshëm. Krijimi i tij është proces i cili kërkon objektivitet dhe qartësi, e me siguri edhe një dozë të caktuar distance emocionale nga të gjitha faktet dhe ngjarjet të cilat shqyrtohen... Ai nënkupton komunikim të lirë – jo vetëm ndërmjet nacionales dhe simbolikes, por edhe ndërmjet institucioneve dhe publikut. Kjo është ajo që kishte më së paku në dy dekadat e fundit, e kjo na duhet më së shumeti.”

Diskutimi

Reagimet më të shumta i shkaktuan lavdërimet që iu bënë Tribunalit të Hagës nga Jelena Subotić, duke marrë parasysh arkivën e grumbulluar. **Munira Subašić**, kryetare e shoqatës „Lëvizja e Nënave të Enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës”, paralajmëroi se „Tribunalit të Hagës në fund do t'i jepet vlerësimi prej viktime – ka kaluar apo nuk ka kaluar, e mund ta mbrojë kush të dojë, mund të flasë çka të dojë, por ne viktimat kemi të drejtë të themi nëse mandati i tij ka qenë i mirë.” **Simo Spasić**, kryetar i Shoqatës së Familjes së të Vrarëve dhe të të Zhdukurve në Kosovë, e mbështeti qëndrimin e Munira Subašić-it, duke thënë se „Familjet janë ato të cilat do të vendosin nëse do t'i japin mbështetje cilëso gjykatë, duke e llogaritur edhe Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Hagë.”

Amir Kulaglic nga Srebrenica paraqiti një qëndrim mjaft kritik ndaj Tribunalit të Hagës: „ (...) Në Potočare në hyrje të Qendrës Memoriale do të vendosim dy mure, dy shtylla: shtyllën e turpit dhe shtyllën e njerëzve fisnikë e meritore. Zonja Subotić, zotëri Teodor Meron, sigurisht do të jenë në maje të kësaj shtylle të turpit, pavarësisht nëse kjo ju pëlqen apo jo.”

Dragan Pjevač, refugjat nga Kroacia, kryetar i Koordinimit të Shoqatave Serbe të Familjeve të Viktimave, të cilit pjesëtarët e policisë speciale të Kroacisë më 9.9.1993 ia vranë nënën Boja, së bashku me dhjetëra banorë të fshatrave serbë në Medački džep. Ai konsideron se GJNKJ-ja me verdikte të pafajsisë i ka dëmtuar vikrimat në Serbi e në Kroaci: „Dhe ne këtu duhet të konstatojmë se verdiktet e fundit të pafajsisë nga Haga e kthyen procesin e ballafaqimit me të kalurën në fillimin e tij, e ndoshta edhe më larg. Unë këtu veçanarisht e kam fjalën për Serbinë dhe Kroacinë. Procesi i ballafaqimit me të kaluarën është ndalur. Këtë e ilustron me atë se ministri i mbrojtjes i Kroacisë, Ante Kotromanović, në komentën e parë pas verdiktit ndaj gjeneralëve kroatë tha: 'Tani jemi të pastër si loti'”.

Pjesëmarrësit i paraqisnin edhe qëndrimet e tyre në lidhje me Nismën për KOMRA, duke e ngatërruar atë shpesh me Komisionin e ardhshëm.

Andelko Kvesić, përfaqësues i Shoqatës Kroate të të Burgosurve nga Bosnja e Hercegovina, në komentet e tij lidhur me të arriturat e procesit KOMRA, deklaroi: „Nuk jam aspak i kënaqur me atë që ka bërë KOMRA dhe që nuk ka gjetur metodë që aktivitetin e saj ta afrojë edhe tek popullata kroate në Bosnje e Hercegovinë”.

Kada Hotić nga shoqata „Lëvizja e Nënave të Enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës”, tha: „Iu gëzova KOMRA-së në fillim. Mendoj se edhe ajo i ka disa rezultate, por prapëseprapë mbetem e hutuar – çka kemi definuar, cili do të jetë konkluzioni dhe çka do të shkojë para qeverisë.”

Vesna Teršelič ftoi për durim dhe investim më të madh të energjisë: „Duhet të investohet më shumë energji edhe më tutje në mënyrë që Nismën për KOMRA t'ua afrojmë të gjithëve dhe të vazhdojmë të shpjegojmë pse do të ishte aq e rëndësishme të kemi një komision i cili do të merret me hulumtimet e mëtejme të fakteve, si për krime ashtu edhe për fatin e viktimave dhe të kryesve të atyre krimeve. E kuptoj që po na humb durimi e posaçërisht e kam parasysh që po u humb durimi të gjithë atyre nga shoqatat dhe asociacionet e viktimave, sepse që nga viti 1991 kanë kaluar më shumë se njëzet vite e aq pak është bërë në gjykime dhe në të gjitha fushat tjera të ballafaqimit me të kaluarën. Përgjegjësjë mbetet mbi supet tona që të jemi më të suksesshëm në përafrimin e gjithë asaj që e propozojmë përmes kësaj Nisme me opinionet tona pubike.”

Kushtrim Koliqi nga organizata INTEGRA nga Kosova e kritikoi Grupin Ndërkombëtar për Ballafaqim me të Kaluarën të cilën e themeloi Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, në të cilën ka përfaqësues të institucioneve qeveritare e joqeveritare, si dhe të institucioneve ndërkombëtare, mirëpo nuk ka asnjë përfaqësues të viktimave. Kjo, sipas tij, paraqet një fiasko për atë grup ndërkombëtar mandati i të cilit është ta sajtojë një strategji për ballafaqim me të kaluarën, respektivisht për shqyrtimin e trashëgimisë së luftës, e këta në fakt janë viktimat.

Branislav Radulović, jurist nga Podgorica, vlerësoi se mbajtja e Forumit në të njëjtën ditë kur Šešelji-i mban mitingun e tij paraqet një arritje të madhe të drejtësisë tranzicionale: „Ekziston një njësi matëse, e kjo është mitingu i radikalëve sot, këtu në Beograd. Unë tani ju pyes – kush janë fitimtarët? Vetëm merreni me mend situatën para dhjetë vitesh, a ishte e mundur që ne këtu, në këtë sallë, të bisedojmë e ata në shesh? Ky do të ishte disproporcion i panatyrshëm i fuqisë, dhunës, forcës kundrejt grupit të njerëzve i cili beson në vlerat themelore njerëzore. Sot ne jemi këtu, pavarësisht asaj se disa vërtetë kanë humbur shumë, para së gjithash më të dashurit e tyre, fitimtarë në sistemin e vlerave në raport me ata njerëz të cilët tani janë humbës atje në njëfarë sheshi”

Amir Kulaglic nga Srebrenica: „Çka u ka mbetur viktimave, çka u ka mbetur viktimave të Srebrenicës pas njëzet vitesh, përveç se të flasin. Ai rrëfim i yni sigurisht ka më shumë qëllime. Piksëpari, të prodhojmë dhembshuri në mesin e atyre të cilët deri më sot nuk na kanë përjetuar si viktima. Së dyti, ta shtyjmë komunitetin akademik, komunitetin e drejtësisë, organizatat civile që të jeni pjesë e frontit i cili, të paktën pjesërisht, do të na mundësojë njëfarë drejtësie. Së treti, unë ndjej se, nëse nëna Munira apo nëna Kada apo cilado nënë nuk paraqitet të flasë për dhembjen e vet, për vuajtjen e vet... Dhe nëse unë nuk paraqitem, ndjej se i kam tradhëtuar ato viktima dhe jam bërë bashkëpunëtor i atyre të cilët i kanë vrarë viktimat tona. “

Sa i përket të arriturave të procesit KOMRA, Kulaglic-i paraqiti gjykimin e tij: „Ajo që më gëzon këtu është se viktimat nuk e kanë humbur besimin në Nismën për KOMRA dhe se janë të gatshme që edhe më tej të luftojnë për atë që ajo që e kemi nisur të çohet deri në fund. Dhe ky duhet të jetë mesazhi i këtij tubimi tonë dhe mos e humbni durimin. Nëse ne nuk e bartim këtë barrë deri në fund, kjo nuk do të ketë sukses. Vetëm edhe një gjë, për të cilën më vjen posaçërisht mirë: mos të mashtrohemi me ekskluzivitetin, KOMRA është gjëja e vetme e mirë në një segment të drejtësisë tranzicionale, por si të bëhet, si të bëhet integrimi me shtyllat tjera të drejtësisë tranzicionale dhe me mekanizmat e saj?”

Fikret Grabovica, kryetar i Shoqatës së Prindërve të Fëmijëve të Vrarë të Sarajevës: „KOMRA vërtetë është një ide e mirë, vetëm se shtrohet pyetja se në çfarë mase dhe në çfarë kapaciteti do të realizohen qëllimet e parapara me Statut. Meqë zotëri Anđelko Kvesić tha se ai është përfaqësuesi i vetëm i shoqatave kroate nga Bosnja e Hercegovina, shtrohet dilema nëse dhe në çfarë mase do të mund të realizohen këto detyra të KOMRA-së, nëse nuk janë të përfaqësuar në masë të duhur kroatët dhe serbët boshnjakë si dhe shoqatat e tyre. Duhet bërë përpjekje në mënyrë që të përfshihen të gjithë ata të cilët do të mund të përgjigjen dhe të cilët do të marrin pjesë në zbatimin e gjithë atyre detyrave. Sepse nëse kjo nuk ndodh, kam frikë se do të ketë shumë mangësi në realizimin e KOMRA-së. “

Milislav Stojković, kryetar i shoqatës „Qendra për Mbrojtjen e Familjeve të Viktimave të Luftës në Kosovë“, e parashtoi pyetjen e njëjtë lidhur me raportin ndërmjet viktimave dhe kriminelëve: „A na duhen neve përsëri njëqind vjet, siç flitet tani për Luftën e Parë Botërore: disa flasin në një mënyrë, të tjerët në një mënyrë tjetër. Kur do të piquet mendimi, një qëndrim real e një arsyeshmëri që të mos barazohen viktimat dhe agresorët, gjë që bëhet me ngulm në të gjitha hapësirat. Deri kur edhe viktimat edhe agresorët?“

Mirjana Učakar nga shoqata Të Fshirët nga Sllovenia: „Ne në Slloveni kemi me qindra veteranë të luftës, heronj. Te ne nuk flitet fare lidhur me atë se vriteshin ushtarë të rinj të moshës nëntëmbëdhjetë e njëzetvjeçare. Te ne kemi vetëm heronj të cilët kanë fituar në luftën dhjetëditore. E kemi presidentin i cili nuk mërzhitet për problemet e të fshirëve.“

Temelko Risteski, dekan i Fakultetit Juridik në Shkup: „Ju ftoj që t'i konfrontojmë ndarjet që i bëjnë politikanët, sepse ndarjet, ndasitë në hapësirat ballkanike në bazë të përkatësisë nacionale e fetare, shumë lehtë mund të kalojnë në kundërshti antagonistike. Ne kemi parë se çka është lufta civile. Për pasojat e luftës civile, për pasojat e rënda kanë folur të gjithë këtu sot. Dhe kemi dëgjuar gjëra të tmerrshme. Dhe nuk guxojmë të lejojmë që kjo të na përsëritet. Vlera më e lartë njerëzore është jeta, prandaj duhet të punojmë për të krijuar një klimë për jetën e përbashkët.“

Moderator ishte Nenad Golčevski, Outreach program, GJNKJ.

Paneli III: Nga këndi i viktimave

Bekim Gashi nga fshati Tërnje, komuna e Suharekës, Kosovë. Pjesëtarët e brigadës 549 të Ushtrisë së Jugosllavisë më 25 mars 1999 vranë së paku katërdhjetë banorë të fshatit Tërnje, ndër të cilët edhe nënën e Bekimit dhe katër motrat e tij: Selvetën, Luljetën, Blertën dhe Lumtruriën. Trupat e tyre ende nuk janë gjetur. Për krime lufte në fshatin Tërnje, Prokuroria e Republikës së Serbisë për krime ngriti aktakuzë kundër dy oficerëve të brigadës 549. Deri në fund të vitit 2014 nuk ka filluar gjyqimi.

„Nuk e di nëse mund ta paramendoni gjendjen time shpirtërore, por nëse vetëm për një çast do të hynit në shpirtin tim, do ta ndjenit dhembjen time; për mua kjo është dhembja më e madhe në botë. Unë dhe të gjithë shqiptarët dëshirojmë të jetojmë në paqe dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me serbët, gjë që e obligon shtetin dhe popullin serb të kërkojnë falje për krimet, terrorin dhe barbarizmin ndaj popullit shqiptar.“

Nada Bodiroga, e lindur në Slavsko Polje, Kroaci. Prindërit e saj, Danica dhe Teodor Samardžija, mbetën në fshat pas aksionit të forcave kroate „Stuhia“, më 4 gusht 1995. Ajo ende pret rezultate të analizës së mbetjeve mortore të gjetura te dyert e shtëpisë së djegur të prindërve. „Përgjigjia ka qenë, e kam dëgjuar secilën fjalë: '(...) mbetjet e gjetura nuk janë të origjinës njerëzore, por shtazore.' Përsëri kam përjetuar një shok. As nuk më kujtohet se si kam dalur nga ndërtesa e policisë. Ende nuk mund të flej. Thjesht nuk di kujt t'i drejtohem më, kë ta pyes, kujt t'i besoj. Kërkoj vetëm një gjë – të më informoni me shkrim nëse e kanë kryer analizën dhe të cilës origjinë janë mbetjet e djegura. Do ta përballoj. Nuk do të heq dorë. Dua ta di të vërtetën, kam të drejtë ta di të vërtetën“.

Kada Hotić nga Srebrenica, anëtare e Shoqatës „Nënat e Enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës“. Ka jetuar në Srebrenicë me bashkëshortin Senadin dhe të birin Samirin. Të dytë u vranë në periudhën nga 11 deri 17 korrik 1995.

„Kurrë nuk ka ardhur, as sot e kësaj dite... Jam inkurajuar, jam forcuar për të luftuar për t'i kërkuar të zhdukurit, për ta kërkuar fajtorin. Dhe jam bërë e vështirë, dhe qaj, dhe përsëri them – të paktën nuk më vjen turp nga askush. Askush nga të mitë nuk ka qenë kriminel. Falë zotit, nuk kanë qenë. I kam vuajtjet e mia, lotët e mi, dhembjen time. Por si do të flejë kriminelin kur t'i kthehen pamjet? Thashë, ai e ka më vështirë. Kemi marrë një letër nga Vlasenica ku njëri e ka përshkruar ashtu ngjashëm jetën të cilën nuk do t'ia dëshiroja askujt, as atij armiku i cili ma ka vrarë të birin“.

Sunčica Antić, person i zhvendosur nga Kosova. Jeton në Serbi. Më 31 korrik 1999 në fshatin Koretin, komuna e Kamenicës, u vra bashkëshorti i saj Negovani dhe daja i saj Novica Ilić. I varrosën pjesëtarët e KFOR-it në varrezat në Kamenicë. Për pesëmbëdhjetë vjet me radhë pa sukses është përpjekur që nga administrata e UNMIK-ut dhe KFOR-it të marrë një dokument se bashkëshorti i saj u vra. Vetëm para disa muajsh arriti ta marrë certifikatën e vdekjes në bazë të së cilës i ka rregulluar të drejtat themelore sociale për vete dhe fëmijën e saj.

Mevludin Lupić vjen nga Zvorniku, nga familja Lupić, nga e cila u vranë pesëmbëdhjetë meshkuj nga 1 deri 7 qershor 1992. Babai i tij Ramo, xhaxhai dhe fëmijët e xhaxhait – të gjithë u pushkatuan në Gerina klanica në Karakaj, në Zvornik. Me përkushtim dhe organizim të anëtarëve të familjes të dëshmojnë përpara gjykatës hetuese në Beograd, Mevludini drejtpërdrejt kontribuoi që Prokuroria për krime lufte e Serbisë të ngritë aktakuza kundër kryetarit të luftës të komunës së Zvornikut dhe komandatit të Mbrojtjes Territoriale për vrasjen e rreth shtatëqind meshkujve, të robëruar me 1 qershor 1992 në Bijeli potok.

„Kur përfundoi procesi gjyqësor në Beograd, kur në verdikt e pashë emrin e babait tim dhe vërtetimin për vdekjen e tij, shpresova se të paktën deri diku do të vihet drejtësia në vend. Megjithatë, verdiktet kanë qenë katastrofale. Njeriu i cili e kishte gjithë pushtetin u dënua me gjashtë vjet burg. Njeriu i cili ka komanduar me Mbrojtjen Territoriale dhe me të gjitha ato njësite atje, u dënua me pesëmbëdhjetë vjet burg. Vuajtjet tona mbesin me ne, dhe mund të na ngushëlloni me dhembshuri, e kjo na duhet...“

Ljubiša Filipović, person i zhvendosur nga Kosova, jeton në Malin e Zi.

„Unë kam arritur që, përmes ndihmës së Fondit të Britanisë së Madhe, në Prizren të ndërtohen dhjetë shtëpi për të kthyerit. Ato shtëpi u ndërtuan në themele të vjetra, por në ato shtëpi edhe sot e kësaj dite nuk janë vendosur njerëzit. Nuk ka liri të lëvizjes, askush nuk u garanton siguri, nuk kanë punësim dhe njeriu nuk mund të mbijetojë dhe të jetojë poshtë. Duhet punuar për pajtim, për kthim, për kthim të përhershëm.

Besoje se, para së gjithash, së pari duhet të vijë deri te pajtimi në mesin e popullit, dhe vetëm atëherë do të jetë i mundur kthimi. Përndryshe, nuk ka mënyrë tjetër.

Marica Šeatović nga Novska në Kroaci. Bashkëshorti i saj Mihajlo u vra më 21 nëntor 1991, ku u vra edhe çifti bashkëshortor Išo dhe Sajka Rašković-i, si dhe Ljubomir Vujić-i, të gjithë në shtëpinë e familjes Rašković. Këta i vranë pjesëtarët e ushtrisë kroate të Brigadës së parë të rojeve „Tigrat“.

„T'ju them, unë kam shkuar në të gjitha dëgjimet dhe ai që i kalon të gjithë ato gjykata në cilindo shtet nga këto që janë formuar rishtazi... Mendoj se vetëm ata njerëz që janë të fortë, të vullnetit të qëndrueshëm, mund ta përballojnë këtë. Për të gjitha padrejtësitë që ju bëjnë në ato gjykata, kur fajtorët apo urdhërdhënësit e tyre gënjejnë, ju gënjejnë në sy, ju këtë thjesht nuk mund ta duroni. Kjo është e pashembullt. Në fund, në gjykimin e përsëritur, të dy të akuzuarit u liruan. Edhe ky që u dënua në mungesë (...) Tani ky është verdikt i plotfuqishëm, nuk e kam lexuar, por kryesisht gjykatësi në njëfarë mënyre e ka arsyetuar se, megjithatë, shteti kroat është fajtor, sepse prindërit e mi i vranë ushtarët kroatë. Dhe aty kam, të themi ashtu, njëfarë satisfaksioni”.

Amir Kulagić nga Srebrenica. Babai i tij Safeti u vra më 8 maj 1992 me armë zjarri në shpinë. Kishte mbi gjashtëdhjetë vjet. Ishte 100 përqind invalid. Ishte me paterica. Të dy këmbët i kishte të thyera.

„Babai im është njëri nga shembujt e krimeve pa dënim. Në mesin tonë ka shumë përvoja të ngjashme – kemi njohuri, nuk kemi njohje, por ka shumë krime pa dënime të cilat sigurisht për një kohë të gjatë do të mbesin në shpirtat e të gjithë neve që kemi përjetuar humbje. Unë kam menduar se njeriu njëherë vdes, njëherë kur e humb jetën fizike. Megjithatë, gjetja e eshtrave në katër apo pesë varreza masive na dëshmon se mund të vdisni edhe për herën e dytë. E copëtojnë trupin, pastaj e shpërndajnë atje diku rreth e rrotull. (...) Jo vetëm që e kanë copëtuar trupin, por pastaj vjen deri te një mohim sistematik që ata njerëz vërtetë kanë ekzistuar dikur. Kjo është gjëja më e vështirë që ju vjen në fund, të themi ashtu, si një goditje përfundimtare ndaj jush”.

Nikola Šašo, refugjat nga Kroacia. Prindërit e tij, Ljubica dhe Petar, jetuan në Banija, më fshatin Ljeskovac. Nëna e tij ishte e palëvizshme. U vranë më 5 gusht 1995 në Dvor na Uni. U larguan nga kolona e refugjatëve dhe u lajmëruan për të mbetur në Kroaci.

„(...) Kemi pritur shumë, dymbëdhjetë vjet, por ju dëshiroj që ta gjeni qetësinë shpirtërore ashtu siç e kemi gjetur ne tani. **Ne kemi arritur t'i varrosim prindërit tanë në Beograd. Ata e kanë fituar banesën e tyre të amshimit, ato eshtra të tyre. Ne jemi të kënaqur me këtë.** Dhe tani duhet të nisë kjo pjesa e dytë, që të gjenden ata të cilët i kanë kryer ato krime, kjo mbetet të jetë një punë tejet e vështirë”.

Munira Subašić, kryetare e „Lëvizjes së Nënave të Enkalave të Srebdenicës dhe Zhepës“.

„Në gjenocidin e Srebrenicës unë i humba njëzetedy anëtarë të familjes sime të ngushtë dhe ndoshta më shumë se njëqind të familjes së gjerë. Vitin e kaluar i varrosa vetëm dy eshtra të vogla të birit tim Nerminit, të cilat u gjetën në dy varreza masive, njëzetepesë kilometra larg njëra tjetrës. Dhe mendoj se unë nuk kam lindur një fëmijë të tillë, e kam lindur me duar e këmbë, me sy e kokë dhe me të gjithat. Dhe ja fatkeqësia. Por përsëri e kam një nishan në mesin e 6.500 shokëve, fqinjëve, miqve të tij dhe në njëfarë mënyre jam e kënaqur. **Kam gjetur të paktën njëfarë qetësie.**”

Desanka Pejčinović, person i zhvendosur nga Kosova. Ajo e pa për herë të fundit birin e saj nëntëmbëdhjetëvjeçar Slobodanin më 26 mars 1999 kur pas mëngjesit doli në qytet [Pejë]. Nga fqinja e saj dëgjoi se ai kishte shkuar me shokët e tij shqiptarë përtej bjeshkës.

„Ne kemi qenë të gatshme t'i falim të gjithat dhe të mbesim të turpëruara për hir të së vërtetës. Nuk janë në mesin e të vdekurve dhe as në mesin e të gjallëve, prandaj i lus, jo vetëm KOMRAnë, por të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, njerëzit me karakter, njerëzit zemërgjerë, që të na

ndihmojnë. Është e padurueshme të priten eshtrat, t'ia bëj një varr, t'i dal hakut si nënë. Ndoshta ju kam ngarkuar, por e kam vështirë, ju do të më kuptoni më mirë sesa të tjerët.”
Desanka e lexoi poezinë e Dragica Majstorović-it, të cilës iu zhduk i biri Ivani, nxënës i vitit III të gjimnazit në Prishtinë, më 19 gusht 1999.

*Vrasës, do të jesh i falur, veç më trego ku ma varrose të birin?
A ia vure gurin e Llapit në gjoks, apo e mbulove me rërën e Sitnicës?
Ndoshta e le në arën time?
Si e gjykove, çfarë faji i gjete, çka i the në fund?
A ia lidhe sytë apo e shikove në sy me plot guxim?...*

Sesionin e moderoi **Nataša Kandić**.

Paneli IV: Përdorimi i fakteve në shfaqjet teatrale

U shfaq një video hyrëse me pjesë të gjashtë shfaqjeve të cilat merren me luftën në Jugosllavi dhe me faktet lidhur me të; pjesa e parë nga shfaqja „Hipermezija” me regji të Selma Spahić (BiH), posaçërisht të bën „të qeshësh sepse shfaq qiramarrës të hutuar të një rrokaqielli sarajevas të cilin ushtari në vijën kufitare e klasifikon sipas nacionalitetit dhe kërkon që të nënshkruajnë se po e lënë pronën e tyre me vullnetin e tyre... Kur shikohet videoja e plotë, mund të shihen, për shembull, të rinjtë që e luajnë veten e tyre („Generacija 91-95”, regjia: Borut Šeparović, Kroaci), të cilët prindërit apo shoqëria e tyre me ideologjitë helmuese kanë dashur t'i fusin në luftë apo, në anën tjetër, mund të shihet shoqëria kosovare („Patriotic Hipermarket”, regjia: Dino Mustafić) ku serbët dhe shqiptarët pranojnë se „edhe njërit edhe tjerët janë muta” dhe se është shkaktuar shumë fatkeqësi për shkak të marrëzisë, ligësisë dhe primitivizmit. Shihet edhe pjesa nga shfaqja „Aleksandra Zec” (regjia: Oliver Frljić, Kroaci) e cila e përshkruan ngjarjen autentike të vrasjes së të miturës Aleksandra Zec, të babait dhe nënës së saj, si dhe e gjithë barra e fajit dhe e përgjegjësisë të cilat e kanë ngarkuar ndërgjegjen e shoqërisë kroate... E shikuam edhe raportin teatror të të mbijetuarve nga Srebrenica („Potočari Party”, regjia: Stevan Bodroža, Serbi), si dhe raportin mbi shqetësimin sistematik të publikut në Slloveni, me rastin e shfaqjes „Izbrisani”, të regjisorit Oliver Frljić.

Sesionin e moderoi kritiku i teatrit **Bojan Munjin**.

Përdorimi i fakteve të luftës në filma

Filmat e përzgjedhur bazohen në faktet të cilat janë të pranuar gjerësisht, në disa raste edhe të vërtetuara para gjykatës, por që nuk janë të njohura gjerësisht apo fshihen nga vëmendja e opinionit publik. U përgjodhën shembuj njerëzish të cilëve lufta ua ndryshoi jetën në mënyrë dramatike, me vetëdijen e plotë se i ka ndryshuar jetët e të gjithë neve. Duke marrë parasysh orientimin themelor të Nismës për KOMRA u theksua këndi i viktimave. Qëllimi ishte të shqyrtohet dhe të komentohet roli i filmit si mjet i tematizimit të atij këndi dhe instrument i hulumtimit të personazhit dhe kontekstit në raport me këtë problem të parashtruar specifik.
Filmi „Tri dritare dhe një varje”¹⁴, autor i të cilit është Isa Qosja, flet për një shqiptarë të dhunuar e cila nga viktimja shndërrohet në fajtor sepse rrëfimin e saj ua tregoi prindërve të saj. Regjisorin **Janko Baljak** foli për hulumtimin thelbësor mbi të cilin u bazua filmi i tij „Vukovar – prerja e

fundit “ dhe për përvojën e veçantë të punës rreth koproduksionit të parë të Kroacisë e Serbisë në një film të këtij lloji. **Ivana Lalić**, autore e filmit „Dëshmitarët“, shfaqti incizimet e dëshmitarëve kyçë në proceset gjyqësore për dhunën ndaj civilëve në Kosovë. Pranimi i rolit të dëshmitarit të mbrojtur e ndryshon në mënyrë drastike edhe jetën e mëtejme në bashkësi edhe perceptimin e tij të ngjarjeve për të cilat dëshmon, ndonjëherë edhe për gjithë pjesën e mbetur të jetës së atij personi, duke përfshirë edhe identitetin. „Fëmijë si gjithë të tjerët“, filmi i **Pjer Žalica**, është një vështrim mbi fëmijët të cilët kanë dalur të dëmtuar nga lufta, edhe fizikisht edhe psikikisht. Duke e shpalosur botën e tyre të brendshme, Žalica theksoi se në BeH nuk ka fëmijë që nuk janë të dëmtuar nga lufta.

Sesionin e moderoi regjisori **Lazar Stojanović**.

Fjala përmbyllëse: Žarko Puhovski

„Të arriturat tona ende qëndrojnë pezull, por ekzistojnë. Kemi një shans të madh të kalojmë nga sfera e shoqërisë civile në atë ndërshtetërore. Dhe kjo do të ishte një e arritur jashtëzakonisht e rrallë për shoqërinë civile. Me fjalë tjera, po fillon një fazë plotësisht e re.

Po që se ndodh që të ketë sukses puna me KOMRA-në, kjo do të jetë shenjë e gjithëmbarshme për gjithë hapësirën e ish Jugosllavisë se po ndërpriten të gjitha gjykimet për krime lufte. Kjo nuk është logjikisht e lidhur, kjo nuk është e drejtë, por konstatoj se kjo do të ndodhë nëse nis KOMRA, sepse do të thonë 'në rregull, tani ata e bëjnë këtë punë, lëre këtë, ka kaluar shumë kohë, nuk do ta çajmë kokën më me këtë, le ta bëjë fqinji këtë', pasi që, në këto shtete në të cilat jetojmë ne, gjykatat janë pjesa më e keqe e organizimit shtetëror. Pse?, Sepse fare nuk e shohin veten si pjesë e organizimit shtetëror. Ata gjithmonë flasim për shtetin si për diçka që ata nuk janë, dhe prandaj me gjykimet për krime lufte deri më tani silleshin— kjo u dëshmuar e u tha në mjaft raste këtu – si me diçka që është detyrë shtëpie e cila ka ardhur nga jashtë. Pas KOMRA-së, askush nga jashtë nuk do t'u bëjë presion më, dhe kryesisht as nga brenda. Gjithë këto gjëra janë për fat të keq realitet. Dhe gjëja e dytë që mua më duket tejet e rëndësishme, u fol për drejtësinë. Ky vit shënon njëqindvjetorin e Luftës së Parë Botërore. Aq shumë gënjeshtër, aq shumë mashtrime, aq shumë nacionalizëm, pas njëqind vjetësh, në interpretime të Luftës së Parë Botërore dëshmon se nuk duhet pritur që „vetëm“ pas njëzetepesë vitesh nga luftërat e Jugosllavisë gjithçka do të jetë e qartë.

Edhe sa punë mbetet para nesh? Dhe nëse ndodh që këto t'ua dorëzojmë të tjerëve, shteteve, neve na mbeten këto gjëra të vogla – gjyshja ime e ndjerë do të thoshte – thurja e vetëdijes publike rreth asaj se çka kanë bërë tanët. Meqë, sa i përket asaj që të tjerët kanë bërë, për këtë flasim të gjithë sa të duan. Nuk ka dyshim për atë se shumë kryes as që do të identifikohen, e lëre më të dënohen. Me këtë duhet të jetohej. Tani bëhet fjalë për atë se duhet të turpërohen pozitat politike të cilat kanë çuar drejt luftës. Me këtë do ta bëjmë edhe një gjë të cilën të gjithë këtu e hedhin poshtë, e ne do ta bëjmë: do ta barazojmë viktimën dhe agresorin, sepse do t'i numërojmë e do t'i emërojmë viktimat, e viktimat kanë pasur edhe njëherë edhe tjerët. Nëse ia dalim të kemi edhe rrethanat e vdekjeve, ne do ta kemi edhe bazën që, përfundimisht, lufta të marrë fund “.

Fjala përmbyllëse: Nataša Kandić: „Unë jam optimiste. Në debatin rreth detyrave të KOMRA-së, duke u nisur nga feja e krishterë se të gjithë njerëzit janë të barabartë në vdekje, u kristalizua qëndrimi se KOMRA duhet t'i regjistrojë humbjet njerëzore, civilët e luftëtarët apo siç thotë Žarko, „viktimat dhe agresorët“, pastaj, të vërtetohen rrethanat në të cilat ata e kanë humbur

jetën. Sa i përket marrëdhënieve ndërmjet gjykatave dhe KOMRA-së, kemi konstatuar se KOMRA, falë karakterit regional dhe grumbullimit intenziv të të dhënave në një afat të kufizuar kohor, ka shanse të mëdha t'i heqë kufizimet e gjykimeve të cilat, ndër të tjera, lindin si rezultat i vështirësive në grumbullimin e fakteve në pronësi të shumë shteteve, si dhe t'i shtyjë përpara gjykimet, që sot ndodhin më pak sesa para pesë vitesh. Ky ka qenë vlerësim edhe i përfaqësuesve të organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut në panelin e djeshëm. Një gjykim zgjat disa vjet, ka pak verdikte të plotfuqishme, viktimat janë të dëshpëruara me gjykimet, shërbimet gjyqësore i ftojnë të dëshmojnë dhe pas kësaj nuk lajmërohen më kurrë. Të gjitha aktivitetet e KOMRA-së do të organizohen në periudhën kohore paraprakisht të caktuar, në afat prej tti vitesh, që do të sjellë drejtpërdrejtë koncentrim të dëshmimeve dhe të fakteve tjera. Ky do të jetë një presion i madh për gjykatat. Përveç kësaj, themelimi i Gjykatës Speciale për krime lufte të kryera nga pjesëtarët e UÇK-së është argument i fuqishëm juridik kundër qëndrimit pesimist se themelimi i KOMRA-së do të çojë drejt ndërprerjes së gjykimeve për krime lufte. Bëhet fjalë për dy mekanizma – KOMRA mund të nxisë gjykime të reja, ndërsa faktet e vërtetuara gjyqësore do t'i ndihmojnë KOMRA-së të formojë një pasqyrë të gjithëmbarshme të asaj që ka ndodhur“.

Nisma për KOMRA në media

Në periudhën e vëzhguar, vetëm vendimi i Kuvendit të Koalicionit për KOMRA mbi përkrahjen për Ndryshimet e Statutit të të dërguarve për KOMRA-n dhe mbajtja e Forumit për drejtësinë tranzicionale kanë tërhequr një vëmendje më të madhe të mediave, posaçërisht në Kroaci dhe në Mal të Zi. Gazetarët, për ngjarjet kanë raportuar në kontekst të mitingut të Sheshelit, duke e theksuar kontributin e Koalicionit për KOMRA në rehabilitimin e viktimave nga frika, të cilën gjatë luftës e kanë mbjellë çetnikët. Vlerësimi i gazetarëve ka qenë se KOMRA është duke u shndërruar në projekt ndërkombëtar¹⁰.

Gazetari i gazetës ditore „Slobodna Dalmacija“, Damir Piliq, qëndrimin e tij në Beograd e ka përshkruar me fjalët si më poshtë:

¹⁰ **KOMRA do të vërtetojë faktet mbi krimet e luftës në ish-Jugosllavi**, Tportal.kr, 18.11.2014.

<http://www.tportal.hr/vijesti/hrvatska/359289/Rekom-ce-utvrđiti-cinjenice-o-ratnim-zlocinima-u-ex-Jugoslaviji.html> (qasur në datën 16.12.2014)

Një hap më afër drejt formimit të KOMRA-s, Sven Milekiq, BIRN Zagreb, 18.11.2014.

<http://www.balkaninsight.com/rs/article/korak-bli%C5%BEE-ka-formiranju-rekom-a> (qasur në datën 16.12.2014)

Komra shndërrohet në projekt ndërshtetëror, Boris Paveliq, NoviList.kr, 18.11.2014.

<http://m.novolist.hr/PogledajClanak.aspx?id=725689&datum=20141118> (qasur në datën 16.12.2014)

Koalicioni për KOMRA i ka përkrahur Ndryshimet e Statutit të KOMRA-s, PCNEN, 18.11.2014.

<http://www.pcnen.com/portal/2014/11/18/koalicija-za-rekom-podrzala-izmjene-statuta-rekom/> (qasur në datën 16.12.2014)

Komra do të vërtetojë faktet mbi krimet e luftës në ish- Jugosllavi, Tportal.kr, 18.11.2014.

<http://www.tportal.hr/vijesti/hrvatska/359289/Rekom-ce-utvrđiti-cinjenice-o-ratnim-zlocinima-u-ex-Jugoslaviji.html> (qasur në datën 16.12.2014)

Mrekullia e paqes: REKOM, Svetlana Slapshak, Peshqanik (Pešcanik), 28.11.2014. <http://pescanik.net/cudo-mira-rekom/> (qasur në datën 16.12.2014)

„Skizofrenia ka qenë e plotë: në bregun e majtë të lumit Sava më drejtohet një aktiviste e shquar joqeveritare, luftëtare me vite për të drejtat e viktimave të luftërave ish-jugosllave dhe një nga zërat më autoritativ të ndërgjegjes serbe, kurse në bregun e djathtë të lumit Sava më drejtohet vojvoda i çrregulluar çetnik, një kriminel i padënuar i luftës dhe një nga fajtorët më të mëdhenj për luftërat ish-jugosllave – ndeshje e të papërputhshmeve, e botëve konceptualisht të kundërta.

Dhe, sado që në sallën konferenciale të hotelit “Crown Plaza” – i rrethuar nga viktimat civile të luftës, aktivistët kundër luftës dhe intelektualët e pavarur nga pesë vendet fqinje – jam ndjerë se ndodhem në mesin e njerëzve normal, po aq në Sheshin e Republikës jam ndjerë se ndodhem në mesin e llumit njerëzor. Para hotelit “Crown Plaza” valonin flamujt zyrtar të shteteve të ndryshme, derisa në Sheshin e Republikës valonin flamujt e kaltër të Partisë Radikale Serbe dhe flamujt e zi çetnik me shenjën e vdekjes.

Në hotelin “Crown Plaza” është folur me ton civilizues mbi fatet individuale tragjike të atyre që kanë pësuar në luftë, kurse në Sheshin e Republikës, në mënyrë primitive dhe luftënxitëse, fyheshin kombe të tëra: kroatët janë quajtur ustash, boshnjakët bali, kurse shqiptarët e Kosovës shiptari. Në bregun e majtë të lumit Sava, disa qindra njerëz, me zë të qetë kanë folur për tmerret e luftërave jugosllave, kurse në bregun e djathtë disa mijëra njerëz – prej të cilëve një numër i mirë i veshur me uniforma të zeza guerile të lëvizjes çetnike, me kapela çetnike me kokarda – duke ulëritur kanë thirrur për Serbinë e Madhe dhe luftërat e reja ^{“11}.

Ndryshe nga mediat në Mal të Zi dhe në Kroaci, në Serbi, vetëm portali „e-novine“ ka raportuar për Ndryshimet e Statutit të KOMRA-s dhe për Forumin për Drejtësinë Tranzicionale. Por, revista javore “Vula” („Peçat“), një prej themeluesve të së cilës është edhe Aleksandar Vulini, ministër i Qeverisë së Serbisë, në pesë numra radhazi, nga data 14 nëntor deri në datën 12 dhjetor të vitit 2014, ka botuar tekste në shumë faqe, kundër themelimit të KOMRA-s, me porosinë kryesore se në prapavijë është qëllimi që Serbia të shpallet fajtori kryesor për shpërthimin e luftës, agresionin dhe krimet e kryera të luftës.

Zgjedhjet për kryetar në Kroaci

Në Kroaci, në datën 11.01.2015, është mbajtur raundi i dytë i zgjedhjeve presidenciale. Kryetar i ri i Republikës së Kroacisë është Kolinda Grabar Kitanoviq. Para avokuesve publik të Nismës për KOMRA qëndron detyra që kryetaren Grabar Kitanoviq ta njohin me të arriturat politike në procesin KOMRA.

¹¹ Çetnikët në Shesh, viktimat në hotel, Damir Piliq, Slobodna Dalmacija, 22.11.2014.
<http://www.slobodnadalmacija.hr/Spektar/tabid/94/articleType/ArticleView/articleId/265224/Default.aspx> (qasur në datën 16.12.2014)

Viktimat janë të rëndësishme, kurse jo Sheshelji (Žrtve su važne, a ne Šešelji), Drago Pilsel, PCNEN, 18.11.2014.
<http://www.pcnen.com/portali/2014/11/18/zrtve-su-vazne-a-ne-seselj/> (qasur në datën 16.12.2014)